



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

**LIGJISLATURA IV**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës  
Mbledhja nr. 3  
Prishtinë, më 19 prill 2011  
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE  
MBIKQYRJEN E FORCËS SË SIGURISË TË KOSOVËS**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Ganimete Musliu, Anton Quni, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ibrahim Makolli dhe Rasim Demiri - anëtar të Komisionit.

**Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë:** Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend dite:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30. 03. 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për gjendjen civile;
5. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30. 03. 2011**

**Kryetari** – A ka dikush vërejtje në procesverbal?

**Vjollca Krasniqi** – Fjalja: “Me siguri është teknike”, është thënë se është imja, por është e deputetes Ganimete Musliu.

**Kryetari** – Në rregull administrata do ta korrigjojë këtë.

*U miratua procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 30 . 03. 2011.*

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private**

**Kryetari** – Siç jeni informuar tashmë ka ardhur për shqyrtim Projektligjit për shërbimet e sigurisë private. Ligji vjen në Kuvend për herë të tretë dhe besoj se do të miratohet shpejtë, sepse është ligj i nevojshëm. Ky ligj është në lexim të parë dhe duhet ta kalojmë që në fazën e parë. Gjatë shqyrtimit do ta ta amendamentojmë, në mënyrë që ligji të dalë sa më i mirë. Për përgjegjës, që do të referojë për këtë Projektligj, e propozoj nënkryetarin, Rexhep Selimin, që në seancën e radhës ta paraqesë rekomandimin për miratim në parim. E hap debatin për këtë Projektligj.

**Ibrahim Makolli** - Do të ishte mirë ta shikojmë mirë paraqitjen e rekomandimit në emër të Komisionit, sepse kemi përvojë jo të mirë. Ndodh shpesh që udhëheqësit e Komisionit qëndrimet individuale i paraqesin si qëndrime të Komisionit. Kjo pastaj shkakton përplasje brenda për brenda Komisionit. Për miratim në parim duhet ta paraqesim qëndrimin në emër të Komisionit dhe më pas ta caktojmë një grup të punës.

**Kryetari** – Duhet të pajtohem ta formojmë një grup pune për shqyrtimin e këtij Projektligji. Qëndrimet e Komisionit duhet të paraqiten ashtu siç merren në Komision.

**Rexhep Selimi** - Me vjen mirë që më është besuar të paraqes qëndrimin në emër të Komisionit. Desha të sqaroj se nuk kam për qëllim ta paraqes qëndrimin personal në emër të Komisionit. Asnjëherë nuk do ta beja këtë. Po të doja të paraqitja qëndrim personal e kam mundësinë ta bëjë. Pajtohem të krijohet një grup pune për këtë Projektligj, që të kemi rezultate.

**Ibrahim Makolli** – Nuk mendova se ju do të paraqitni qëndrim personal, por para disa ditësh e kemi pasur një rast, në të cilin kryetari i Komisionit ka folur në emër të Komisionit. Ai për një projektligj ka thënë se është antikushtetues. Nuk është e vërtetë se në Komision është vlerësuar dhe është marr një qëndrim i tillë. Për këtë arsye kemi pasur përplasje brenda në Komision.

**Fatmir Xhelili** - Pajtohem ta kem një përgjegjës për të raportuar në seancë. Gjithashtu mendoj se nëse një anëtar i Komisionit ka qëndrim të kundërt, mund ta paraqesë në mënyrë individuale.

**Vjollca Krasniqi** - Pajtohem që nëse një anëtar i Komisioni ka qëndrim të kundërt ta paraqesë në seancë si qëndrimin individual dhe jo si qëndrim të Komisionit. E kam lexuar në përgjithësi këtë Projektligj dhe mendoj se paraprakisht duhet t'i bëhet një lekturë, në mënyrë që termat të jenë unifikues. Po ashtu ka mospërputhshmëri edhe midis neneve, por në punë e sipër duhet të shqyrtohet dhe të trajtohet mirë deri sa të miratohet në Kuvend.

**Fatmir Xhelili** – Ishte e nevojshme që Projektligji për shërbimet e kompanive private të sigurimit t'i plotësonte normat juridike të licencimit. Gjithashtu ai e rregullon edhe çështjen e kompanive për t'u kujdesur për trajnimet dhe për përgatitjet e punëtorëve të tyre. Po ashtu besoj se Projektligji i standardizon edhe obligimet që i marrin kompanitë për sigurimin privat, qoftë të personave fizikë ose të tjerëve. Projektligji ka edhe mangësitë e veta, kryesisht rreth sanksionimit të kompanive për përmbushjen e obligimeve. Propozoj ta miratojmë për lexim të parë, kurse të metat do t'i mënjanojmë në shqyrtim e sipër.

**Goran Marinković** - Sa u përket punëve të Komisionit në të ardhmen duhet të jemi edhe më bashkëpunues. Edhe unë pajtohem që Projektligji të lekturohet, sepse ka shumë gabime gjuhësore. Një çështje e kam të paqartë: është caktuar mosha 21-vjeçare, për të drejtë pune në këto kompani, por nuk është caktuar se deri në çfarë moshe mund të lejohet puna në këto kompani.

**Kryetari** – Pajtohem që Projektligjit duhet t'i bëhet lekturë, në mënyrë të jetë i kuptueshëm dhe i saktë. Sa i përket moshës, deri kur lejohet të punohet në kompani private të sigurimit, besoj se është e përcaktuar me ligj. Mosha për pension në Kosovë është 65-vjeçare.

**Goran Marinković** - Mendoj se kjo është çështje specifike dhe me interes, prandaj Projektligji duhet ta rregulloë. Po ashtu mendoj se duhet të caktohet mosha më e vjetër për ata që do të punojnë për siguri.

**Rexhep Selimi** - Vetëm desha të shtoj se me ligj janë të rregulluara edhe rastet e pensionimit të parakohshëm, mirëpo nuk është paraparë pensionim i parakohshëm për punëtorët e kompanive të sigurimit.

**Anton Quni** - Pajtohem me të gjitha vërejtjet që u dhanë. Mendoj se në takimet e radhës do të hasim në parregullsi, sidomos në radhitjen e neneve. Për shembull ka raste kur flitet për personelin dhe kalohet te pajisjet, flitet për kompetencat dhe prapë kthehet te personeli. Pra, duhet të bëhet një radhitje më e mirë. Kemi edhe probleme me emërtimin. Në shumë shtete evropiane përdoret termi *industria e sigurimit fizik*. Për këtë duhet të na ndihmojë ndonjë ekspert i kësaj fushe. Mangësi tjetër është, si duhet ta koordinojë punën ky shërbim me ndihmën e parë, me Policinë e Kosovës, me zjarrfikësit etj., në situata kur duhet të veprojnë së bashku. Nuk është precizuar çështja e verifikimit. Në rastet kur do të shitet kompania, a do të verifikohet edhe blerësi apo kur ta blejë licencën e blen bashkë me verifikimin.

**Kryetari** – Grupi që do ta formojmë do ta standardizojë këtë Projektligj. Pesha e këtij Projektligji është e madhe, andaj besoj se do të punohet me seriozitet, në mënyrë që ta kemi një ligj sa më të mirë. A pajtoheni ta formojmë një grup pune, referues i të cilit do të jetë Rexhep Selimi?

*Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri, dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës e miratuan në parim Projektligjin për shërbimet e sigurisë private dhe u caktua grupi i punës në këtë përbërje: Rexhep Selimi - referues, Fatmir Xhelili dhe Anton Quni.*

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për gjendjen civile**

**Kryetari** – Projektligji për gjendjen civile është gjithashtu me rëndësi të veçantë, sepse i rregullon fushën për gjendjen civile, bazën e të dhënave dhe krejt atë që quhet administratë në kuptimin e funksionimit të gjendjes civile në Kosovë. Kam menduar të jem vetë referues i këtij Projektligji, por ju mund ta kundërshtoni, nëse mendoni se dikush është më përshtatshëm për këtë Projektligj. Propozoj ta themelojmë një grup pune.

*Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri, dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës e miratuan në parim Projektligjin për gjendjen civile dhe u caktua grupi i punës në këtë përbërje: Ahmet Isufi - referues, Fatmir Xhelili, Goran Marinković dhe Ibrahim Makolli.*

#### **5. Të ndryshme**

**Kryetari** – Nuk kam ndonjë çështje tjetër, vetëm desha t’ju njoftoj edhe njëherë se ditën e enjte e kemi një vizitë në FSK. Është mirë të shkojmë të gjithë që ta shohim si funksionon FSK-ja dhe që të jemi në kontakt të vazhdueshëm. A ka dikush diçka tjetër për këtë pikë?

Pasi nuk kishte çështje të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora: 10:45

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Ahmet Isufi